



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK Nr. Prot. 03-03/1671/18
 Dep. DPK Br. Prot. 03-03/1671/18
 Nr.faq. 03 Data 14-06-2018
 Broj stranica 03 Datum 14-06-2018
 Nr. pages 03 Date 14-06-2018
 PRISHTINE

DATË/A:	14.06.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1616/18
PËR/ZA/TO:	z. Abaz FONIQI, Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Klinës
CC:	z. Zenun ELEZAJ, Kryetar i Komunës së Klinës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Asfaltimi i Rrugës Volljak dhe Qupevë e lartë "

I nderuari z. FONIQI,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull " **Asfaltimi i Rrugës Volljak dhe Qupevë e lartë** ", me nr. të prokurimit: 634-18-3790-521, dhe me nr. të brendshëm: 634-18-046-521, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Asfaltimi i Rrugës Volljak dhe Qupevë e lartë** ", me nr. të prokurimit: 634-18-3790-521, dhe me nr. të brendshëm: 634-18-046-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 11.06.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1616/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Asfaltimi i Rrugës Volljak dhe Qupevë e lartë*", me nr. të prokurimit: *634-18-3790-521*, dhe me nr. të brendshëm: *634-18-046-521*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Klinës.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike të llojit punë ndërtimore, me vlerë të mesme prej 178.000,00 €. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vërejtur se tek rubrika *III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional*, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga Operatorët Ekonomik të ofrojnë regjistër të kontratave të përfunduara nga lëmia e njejtë ndërtim dhe asfaltim të rrugëve, në periudhën 36 mujore para datës së njoftimit për kontratë. **Mimumum në vlerë të përgjithshme jo më pak se 250.000,00 €.** **Së bashku me referenca apo certifikata të pranimit të projekteve të realizuara, minimum 3 referenca.** **Kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se bien ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.**

Sipas Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 6.2. parashihet se Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj " Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, Autoriteti Kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me Autoritetin Publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse të i'a paraqes drejtpërdrejtë Autoritetit Kontraktues "

Pra në këtë rast do duhej të kërkohej lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave në vlerë totale të gjitha referencave të punëve të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë e jo si në rastin konkret ku është kufizuar numri i projekteve në 3 referenca në vlerë prej 250.000,00 €.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë ekzekutimin e punimeve të ngjashme, andaj, Autoriteti Kontraktues duhet të këtë kujdes që të caktoj kërkesa minimale të kualifikimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 69 Kapaciteti teknik/profesional të Ligjit për

Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

